



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RAPORT MONITORIMI/ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

MINISTRIA E MBROJTJES

2022

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive.....	2
Qasja vlerësuese	4
Metodologjia e vlerësimit.....	4
Gjetjet e raportit	5
Objektivi 1: Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike	5
Objektivi 2: Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies	6
Objektivi 3: Forcimi i rolit të Drejtorisë së Auditimit të brendshëm, kryerja e auditimeve të performancës, me synim forcimin e integritetit të stafit të Ministrisë së Mbrojtjes.....	8
Objektivi 4: Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik.....	9
Konkluzione dhe Rekomandime	11

Përmbledhje Ekzekutive

Ndërtimi i integritetit është një aspekt i rëndësishëm i funksionimit të demokracive dhe një shtyllë e rëndësishme e shtetit të së drejtës. Korrupsioni ndikon shumë në besimin e publikut, dëmton rëndë efektivitetin e institucioneve dhe cenon legjitimitetin demokratik të tyre. Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare.

Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efencës në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, hartoi dhe miratoi Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2020 dhe Instrumentin e Monitorimit të Planit të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.553, datë 30.09.2021.

Ministria e Mbrojtjes ka hartuar “Planin e Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025 dhe Planin e Veprimit 2022-2023”, miratuar nga ministri i Mbrojtjes, me urdhër nr. 516, datë 19.04.2022.

Plani është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, të miratuar nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit të Ndërtimit të Integritetit të NATO-s dhe të Indeksit Qeveritar të Integritetit të Mbrojtjes të Transparency International.

Zhvillimi dhe hartimi i Planit të Integritetit është kryer nga grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes (i përbërë nga përfaqësues nga Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Auditimit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm, si dhe nga Sektori i Sekretarisë, Arkiv, Protokollit dhe Nënregjistrin të NATO-s), gjatë periudhës dhjetor 2021-mars 2022. Gjithashtu, janë përfshirë edhe përfaqësues nga struktura të tjera jashtë grupit të punës, si nga Drejtoria e Mirëadministrimit dhe Pronave dhe Aseteve.

Hartimi i Planit të Integritetit është kryer me asistencën teknike të Qendrës për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes, i Mbretërisë së Norvegjisë (CIDS).

Plani i Integritetit parashikon edhe krijimin e mekanizmit të zbatimit dhe të monitorimit dhe vlerësimit për të matur progresin e arritur.

Koordinatori i Integritetit për Ministrinë e Mbrojtjes ka miratuar “Planin e Aktiviteteve për zbatimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes për periudhën 2022-2023”, përgatitur në konsultim me drejtoritë dhe strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i cili parashikon detyra specifike për drejtoritë dhe strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Plani i aktiviteteve synon përcaktimin e hapave që do të ndiqen nga strukturat, treguesve të zbatimit, si dhe do të shërbejë për të vlerësuar shkallën e realizimit të masave, aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuar në Planin e Veprimit gjatë procesit të monitorimit.

Në këtë mënyrë, Plani i Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes siguron përfshirjen e konceptit të integritetit në aspektet kryesore të punës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, duke i ndërlidhur ato me “Qeverisjen e Mirë, Demokracinë, dhe Shtetin e së Drejtës”, që përbën një nga shtyllat kryesore të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Nisur nga sa më sipër, objektivat strategjikë të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025 janë:


1. Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike;
2. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së Ministrisë së Mbrojtjes;
3. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore;
4. Forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm;
5. Forcimi i integritetit në operacione dhe misionet ndërkombëtare;
6. Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të aseteve;

Plani i Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes është një instrument i luftës kundër korrupsionit, i cili ka të parashikuar masa të identifikuara në 5 fusha të përgjegjesisë institucionale të ministrisë. Plani i Integritetit përmban gjithsej 34 masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë drejtoritë dhe strukturat e vartësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura si dhe grupe institucionale pune. Afati i zbatimit të këtij Plani të veprimit të Planit të Integritetit është deri në vitin 2023.

Në përputhje me kreun 1, pika 1.2 të Planit të veprimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Ministria e Mbrojtjes ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Raporti jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2022, për statusin e zbatimit të tyre, problematikat e hasura në zbatimin e tyre, përmban të dhëna për veprimtarinë operacionale të njërive (drejtorive) të brendshme kontribuuese, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm, burimeve njerëzore dhe profesionale si dhe transparencën dhe komunikimin me grupet e interesuara. Për vitin 2022, Plani i Integritetit ka të parashikuara për zbatim 12 masa dhe 16 aktivitete, në realizim të katër nga objektivat e mësipërm.

Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 12 masash të parashikuara për zbatim për vitin 2022: janë zbatuar 8 masa, në proces zbatimi kanë mbetur 4 masa dhe nuk rezulton asnjë masë e pazbatuar:



Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes, përmban një analizë të përgjithshme të performancës institucionale për t'i rezistuar shkëlqeve të integritetit si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të drejtorive dhe strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, të një grupi të brendshëm pune dhe të koordinatorit të Integritetit. Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuuese.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinator i Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinator i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme (referohu: seksioni Nr. 2.2.6 të Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Institucionet qendrore). Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuuese në këtë raport, të cilat janë: - Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Auditimit, Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatorë, Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm. Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila

njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashikuar për zbatim për periudhën maj-dhjetor 2022; akte dhe dokumente të hartuara; rekomandime dhe konkluzione. Draft-raporti i hartuar është konsultuar me njësitë përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, draft-raporti është miratuar nga ministri i Mbrojtjes.

Gjetjet e raportit

Objekti 1: Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike

Përmes këtij objekti synohet pjesëmarrja në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë të një sërë aktorëve, qofshin institucione shtetërore apo media, grupe interesi dhe shoqëri civile në përgjithësi, duke garantuar që politikat dhe vendimet në lidhje me mbrojtjen të jenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat strategjike, dhe që problemet të mund të identifikohen që në një fazë të hershme.

Ky objektiv përmban një numër prej 4 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira për vitin 2022 nëpërmjet 7 aktiviteteve. Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi:

Objekti 1	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete plotësisht realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht realizuara	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike	Masa/ Aktivitete	4	2	2	-



Për këtë periudhë monitorimi, maj-dhjetor 2022, masa 1.1 e përfshirjes në dokumentet e politikave të Ministrisë së Mbrojtjes të një kuadri orientues për veprimtarinë kundër korrupsionit në sektorin e mbrojtjes, është realizuar me përfshirjen në Direktivën të Mbrojtjes e vizionit të Planit të Integritetit për një sektor mbrojtjeje që ruan integritetin dhe refuzon korrupsionin, duke institucionalizuar standardet dhe parimet më të larta të mirëqeverisjes.

Lidhur me masën 1.3.1 e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit dhe hartimi i Planit të Integritetit të SHPFA, është ngritur grupi i punës në SHPFA dhe është realizuar trajnimi i tij nëpërmjet tre takimeve/trajnimeve me ekspertët e Qendrës për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes i Mbretërisë së Norvegjisë (CIDS). Vijon të mbeten në proces realizimi identifikimi dhe vlerësimi i riskut, si pjesë integrale e hartimit të Planit të Integritetit për Forcat e Armatosura, si dhe masa 1.3.2 koordinimi dhe monitorimi i procesit të vlerësimit të rrezikut të korrupsionit, dhe masave për adresimin e tyre në strukturat e vartësisë nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave e Armatosura.

Lidhur me masën 1.6.1 e hartimit të një programi vjetor për angazhimin e OSHC-së dhe organizimi i takimeve me OSHC-në, është realizuar seanca konsultative me grupe interesi lidhur me politikën e mbrojtjes në kuadër të hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), datë 24.06.2022. Në datën 8 janar Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Arben Kingji e drejtori i Përgjithshëm AKMC, Haki Çako prezantuan në një konferencë për mediat dhe organizata të shoqërisë civile arritjet gjatë vitit 2022 si dhe objektivat e projektet e reja për vitin 2023 në fushën e Mbrojtjes si edhe të Mbrojtjes Civile, duke ftuar të pranishmit në bashkëpunim aktiv dhe dhënie kontributi në realizimin e objektivave. Në datën 13 janar Ministria e Mbrojtjes shpall për konsultim të hapur me institucionet publike, OSHC-të, grupe interesi dhe publikun e gjerë, pyetësonin paraprak për konceptimin e masave prioritare në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit, 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur.

Këtë pyetësor mund ta gjeni gjithashtu në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes: <https://www.mod.gov.al/newsroom-2/njoftime/5877-pyetesor-ne-kuader-te-procesit-te-bashke-berjes-se-masave-prioritare-te-angazhimeve-te-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur-en-ogp>

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Objektivi 2: Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies

Ky objektivi përmban një numër prej 4 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira për vitin 2022 dhe 5 aktivitete, të cilat i referohen specifikisht forcimit të kapaciteteve profesionale me organizimin e trajnimeve për politikën e privatësisë, rishikimin e rregullores së brendshme, draftimin e kodit të dhuratave pjesë e të cilit do të jetë dhe regjistri i dhuratave, si dhe deklarata për marrjen e një dhurate, si dhe draftimin e deklaratës tip të konfidencialitetit

dhe dypunësim. Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies	Masa/ Aktivitete	4	2	2	

Objektivi 2



- Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuar
- Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara
- Masa dhe aktivitete të parealizuara

Lidhur me masën 2.2 që parashikon përfshirjen e trajnimit mbi politikat e privatësisë në kalendarin vjetor të trajnimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe organizimin e trajnimeve për politikat e privatësisë, gjatë vitit 2022, janë ofruar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) online (për shkak të Pandemisë COVID 19) trajnime në formën e webinarëve në fushën e

parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesit. Gjatë vitit 2023 politikat e privatësisë janë përfshirë në kalendarin vjetor të trajnimeve, dhe planifikohet të ushtrohet një kontroll i drejtpërdrejtë nga strukturat e Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve lidhur me ndjekjen e trajnimeve që lidhen me këtë fushë nga personeli i Ministrisë së Mbrojtjes.

Lidhur me masën 2.6.1, rishikimin e rregullores së brendshme, me urdhër nr. 359, datë 28.03.2022 të ministrit të Mbrojtjes është miratuar “Rregullorja për Kodin e etikës për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë”. Neni 17 i saj parashikon rregulla lidhur me dhuratat, argëtimet dhe shpërblimet për punonjësit.

Link: <https://www.mod.gov.al/images/akteligjore/transparenca/transp-2022.pdf>

Lidhur me masën 2.6.2, regjistri i dhuratave është hartuar dhe konsultuar me ekspertët e CISD dhe është në proces miratimi. Masa 2.6.3, draftimi i deklaratës tip të konfidencialitetit dhe dypunësimin, është në proces.


Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Objektivi 3: Forcimi i rolit të Drejtorisë së Auditimit të brendshëm, kryerja e auditimeve të performancës, me synim forcimin e integritetit të stafit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky objektivi përmban një numër prej 2 masash specifike të planifikuara për t’u zbatuar nga njësitë e përfshira për vitin 2022, të cilat i referohen publikimit të raporteve të auditimit dhe monitorimit të faqes së internetit, si dhe caktimit të pikës së kontaktit antikorrupsion.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë Drejtoria e Auditimit dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të përfunduara
Forcimi i rolit të Drejtorisë së Auditimit të brendshëm, kryerja e auditimeve të performancës, me synim forcimin e integritetit të stafit të MM-së.	Masa/ Aktivitete	2	2		



Masa 3.1, publikimi i raporteve të auditimit të jashtëm dhe e raportit vjetor të auditimit të brendshëm, në programin e transparencës (në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale), është adresuar nga Drejtoria e Auditimit, e cila ka përfunduar Raportin vjetor të Auditit për veprimtarinë e DAB për vitin 2022, dhe i është dërguar Komitetit të Auditit për miratim (*sipas ligjit brenda datës 25.01.2023*). Pas miratimit të Komitetit të Auditit, raporti do t’i dërgohet ministrit të Mbrojtjes për miratim. Njëkohësisht, brenda datës 15 shkurt 2023 raporti i miratuar i dërgohet Ministrisë së Financave (*DH/AB- Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm*) dhe publikohet në faqen web të MM-së.


Masa 3.3 është plotësuar me caktimin e pikës së kontaktit antikorrupsion, pranë Drejtorisë së Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Objektivi 4: Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik

Ky objektivi përmban një numër prej 2 masash specifike të planifikuara për t’u zbatuar nga njësitë e përfshira për vitin 2022 , të cilat i referohen publikimit në programin e transparencës i regjistrit të parashikimeve dhe regjistri i realizimeve të prokurimeve publike, si dhe publikimit në programin e transparencës i kontratave të lidhura me operatorë të ndryshëm, si dhe publikimi i donacioneve (nëse ka të tilla). Njësitë raportuese për këtë objektivi janë Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandëve dhe Sektori Web.

Objektivi 4	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete plotësisht realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik	Masa/ Aktivitete	2	2		



Masa 4.4 është adresuar nga Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve dhe Sektori Web për të publikuar “Njoftimin e kontratës” dhe të dhëna të plota mbi procesin e prokurimit në sitin web të Ministrisë së Mbrojtjes.

Link: <https://www.mod.gov.al/index.php/politikat-e-sigurise/te-tjera-nga-mm/prokurime>

Masa 4.5 është adresuar nga Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve dhe Sektori Web për të publikuar në sitin web të Ministrisë së Mbrojtjes “Regjistrin e parashikimit të kontratave” dhe “Regjistrin e realizimit të kontratave”.

Link: <https://www.mod.gov.al/transparence> <https://www.mod.gov.al/politikat-e-sigurise/te-tjera-nga-mm/prokurime/5857-prokurimet-e-ministrise-se-mbrojtjes-nepermjet-app>

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën maj-dhjetor 2022, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Ministria e Mbrojtjes ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit;
- Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura është e angazhuar dhe ka marrë masat për hartimin e Planit të Integritetit për Forcat e Armatosura;
- Drejtoritë e ministrisë kanë shënuar përparime kryesisht në forcimin e kapaciteteve të stafit;
- Është garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e ministrisë për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit www.mod.gov.al;
- Është rishikuar dhe miratuar “Rregullorja për Kodin e etikës për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë”, dhe hartimi i paketës së plotë të kuadrit të etikës, integritetit dhe të instrumenteve e mekanizmave rregullatorë antikorrupsion është në proces finalizimi.

Hapa të tjera

- Të vijohet me jetësimin e parashikimeve në planin e veprimit;
- Të bëhet informimi/kryerja e trajnimeve të brendshme të stafit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura për rregullat e integritetit (Kod Etike dhe rregullat e tij).